Donika Berisha
donika.berisha123@gmail.com
+38349224507

PORTFOLIO

Janar 2025
10000 Prishtinë

info

Surname:	Berisha
Name:	Donika
Date of birth:	21/ 01/ 1998
Nationality:	Kosovar
Residence:	St. “Deshmoret e Kombit” - Ulpiana -Prishtina
Contact:	donika.berisha123@gmail.com / +38349224507

education

Bachelors Degree - Faculty of Civil Engineering and Architecture , Department of Architecture, University of Prishtina.	01/10/2016 - 2019
Masters Degree - Faculty of Architecture and Spatial Planning, University of Bussines and Technology “UBT”.	01/11/2024 - Ongoing

skills

Excellent communicating, presentation and organizational skills.
Great teamwork skills and calm under deadline pressure.
Experience on photo editing and social media management.

Digital Competences

Architecture and Wood construcition prefabrication

ArchiCAD,
Revit,
3dsMax – Vray,
Lumion,
CADWork,
SEMA.

Design and Photography

Adobe Creative Studio - Adobe Photoshop, Adobe Lightroom.
Microsoft Office package: Microsoft Word, Microsoft Excel, Microsoft Power Point.

Languages

Mother tounge
Albanian

Other
English

professional experience

05/2019-10/2019	CIEE Work and Travel Student- USA
01/2021-04/2021	Architectural Photography Editor and Social Media Manager @CreativeFields Editing professional architecture photography and managing social media.
07/2021-Ongoing	Social Media Manager @studioéterne Managing and growing a following for personal blog/archive.
01/2022-05/2022	Working as an Architect at “Olymp Home”, on assignment like: Preparation of prefabrication plans for objects with different functions and quality control to ensure quality and inovative project.
06/2022-11/2024	Working as an Architect at “Instabuilt”, on assignment like: Following and controling a project from conceptual phase to main project, preparation of prefabrication plans for objects with different functions.

specific project

Instabuilt	Prefabricated projects:
October- 2022	“Alves House” - France
November - 2022	“Stuttgart House” - Germany
January - 2023	“4 Houses Project” - Germany
April - 2023	“Belgium House” - Belgium
June - 2023	“Weilrod House” - Germany
July - 2023	“Gedern Double House” - Germany
July - 2024	“Arta House” - Germany
October- 2024	“Swiss Double House” - Switzerland
	Others:
August - 2023	Signature Houses - Luxury Line

Others:	Interior Design:
April - 2024	“Franko’s Penthouse” - Pristina
September - 2023	“House Renovation Project ” - Switzerland
August- 2022	“VSH-phibrows studio” - Rahovec

References available upon request.

bee pavilion

Punimi i diplomës bachelor
“Pavijon informativ për kujdesin ndaj bletëve”

24.06.2022



Koncepti -Waggle Dance / Vallëzimi i rrumbullakët



Ky punim diplome eshtë projekt individual me temën: Pavijion Informativ per kujdesin ndaj bletëve.

Punimi përfshinë pjesën e projektimit të pavijonit dhe planifikimin urban te zones ku gjendet pavijoni. Qellimi i këtij punimi eshtë vetëdijesimi mbi kujdesin ndaj bletëve me anë të një pavijoni informativ te vendosur në një pike pitoreske malore ku do të trajtohet edhe pjesa e urbanizmit e cila do te ketë konceptin e të siguruarit një vend për shfrytëzimin e hapësirave te gjelbërta ku njerëzit te kenë mundësine te përjetojne hapësirën dhe të krijohet një lidhje mes njerëzimit dhe natyrës, saktësisht qëllimi eshte që të krijohet një simbiozë mes natyrës, arkitektures dhe artit.

Koncepti kryesor i zhvillimit te zones urbane eshte bazuar ne menyren e levizjes se bleteve.Bletët "vallëzojnë" në një mënyrë të veçantë, ku lëvizja e tyre ndihmon bletët e tjera të kuptojnë drejtimin dhe distancën për të arritur burimin e ushqimit.
Ky fenomen është shumë i sofistikuar dhe përbën një nga më të avancuarat forma të komunikimit jo-verbal në natyrë, dhe për këtë zbulim Karl von Frisch mori Çmimin Nobel.

baza përdhesës
1:200



baza suterenit
1:200







Objekti ka një dizajn minimal, drejtkëndor, që ngjan me një kosherë të madhe në një kopsht të mirëmbajtur, duke ofruar pamje spektakolare.

Edhe pse i thjeshtë në formë, është kompleks në koncept. Bazuar në zbrazëtirën ("The Void"), ai shkon përtej hapësirës tradicionale, duke u fokusuar në përvojën njerëzore.
Sipas Tadao Ando, arkitektura duhet të krijojë një lidhje mes individit dhe hapësirës, duke e pasuruar ekzistencën e tij. Ky pavijon thekson minimalizimin e funksionalitetit dhe përdor hapësira të mëdha si shprehje fuqie, duke simbolizuar bletët. Thjeshtësia dhe veçantia e tij krijojnë një sfidë për vizitorët, duke i detyruar të reflektojnë mbi marrëdhënien e tyre me mjedisin dhe të kalojnë përtej perceptimit vizual.





-Një nga elementet kryesorë të këtij objekti është mënyra e lëvizjes. Pjesa hyrëse, e thjeshtë dhe transparente, krijon ndjenjën që vizitori ende ndodhet jashtë, duke e lidhur natyrën dhe kulturën. Pavijoni, me simetrinë e tij, ofron një ekuilibër vizual dhe përdor efektin e hapësirës negative, si në pavijonin e Barcelonës, duke drejtuar shikimin në elemente që mund të kishin kaluar pa u vënë re.

Në fund të hapësirës kryesore është një hapësirë e kufizuar nga një gardh xhami, e cila krijon ndjenjën e një pamje të përjetuar plotësisht vetëm pas kalimit përmes shkallëve kryesore. Shkallët ofrojnë një lëvizje 360°, duke ofruar një panoramë të plotë të objektit dhe duke udhëhequr vizitorët në hapësirën e ekspozitës, si një lëvizje bletësh që kalon nga një ekran dixhital në tjetrin.

-Në fund të eksponatëve, vizitorët arrijnë një rethrrotullim që imiton vallezimin e bletëve, ku ndodhet një stol për t'u ulur dhe soditur natyrën, e cila mund të shihet vetëm nga ana ballore e objektit. Objektin e shtjelluar në një terren të pjerrët e bën këtë pamje të mundur.

Pavijoni është një hapësirë e mbushur me elemente të paspecifikuara, një hapësirë hiper-neutral, ku informacionet për bletët dhe kultivimin e tyre janë dixhitalizuar. Ky koncept lidh historinë me teknologjinë moderne, duke krijuar një lidhje mes natyrës dhe inovacionit, si në pavijonet historike dhe ato të ekspozitave të fundit, si Expo 2020 Dubai.

Punimi i diplomës me temën "Pavijoni informativ për mbrojtjen e bletëve" ka si qëllim të ngrisë ndërgjegjë-simin për rëndësinë e bletëve dhe rolin e tyre në ekosistemet natyrore. Përmes arkitekturës, pata mundësinë të trajtoj këtë temë si një kauzë, duke projektuar pavijonin që shërben për të edukuar dhe ndikuar pozitivisht në publik, duke dhënë një kontribut në mbrojtjen e bletëve dhe ndërgjegjësimit shoqëror dhe ekologjik.
Ky projekt është një simbiozë e arkitekturës, natyrës dhe artit, me qëllimin që të "lëmë këtë botë më të mirë se si e gjetëm", duke ndikuar pozitivisht në ruajtjen e biodiversitetit dhe mbrojtjen e mjedisit.- Donika Berisha.

Franco's Penthouse

10.02.2024

Penthouse-i është konceptuar me mjeshtëri për një çift vendas me bazë në Zvicer, me qëllimin që të shërbejë si një rezidencë luksoze për pushime dhe një vendbanim afatgjatë ndërsa ata i afrohen pensionimit.
Koncepti arkitektonik përqendrohet në krijimin e një mjedisi të rafinuar, funksional dhe privat të jetesës, i cili ofron një harmoni të pandërprerë mes modernitetit dhe rehatisë së përjetshme.

Një oxhak mbresëlënës prej guri, i integruar me një raft librash, vepron si një pikë qendrore, ndërsa kuzhina, me akcentet e gurit dhe drurit, ngjall ngrohtësi dhe ekuilibër. Ishulli i gjerë krijon një lidhje organike midis kuzhinës, qëndrimit ditor dhe zonës së ngrënies.

Sistem i integruar “Smart”, siguron komoditet maksimal, duke mundësuar kontrollin e ndriçimit, temperaturës dhe sigurisë.
Pavarësisht madhësisë së tij kompakte, apartamenti ofron hapësira të bollshme për nevojat e çiftit, me dy dhoma gjumi dhe banjo private të përfunduara me materiale të cilësisë së lartë.
Dizajni përqendrohet në elegancën, thjeshtësinë dhe funksionalitetin, duke përmirësuar cilësinë e jetës për çiftin tani dhe në të ardhmen.

Paraqitja dhe materialet e zgjedhura reflektojnë një filozofi gjithëpërfshirëse të elegancës, thjeshtësisë dhe prakticitetit, me çdo aspekt të dizajnit që synon të përmirësojë përvojën e jetesës për banorët e saj. Qoftë duke shijuar qetësinë e brendshme, organizuar ngjarje në tarracë, apo relaksuar në dhomat e gjumit, hapësira është krijuar për të përmbushur çdo kërkesë të stilit të jetesës së çiftit, tani dhe në të ardhmen.



"Zbukurimi është një krim për çdo objekt funksional. Ajo që duhet të bëhet, është që çdo formë e ndërtimit të jetë e thjeshtë, e pastër dhe të ketë vetëm elementët e nevojshëm për të mbështetur funksionin e tij. Estetika duhet të lindë nga funksioni, jo nga zbukurimi."

Ky citat i përshtatet konceptit të kësaj rezidence luksoze, ku arkitektura synon të krijojë hapësira të pastërta dhe funksionale, ku bukuria lind natyrshëm nga thjeshtësia dhe prakticiteti, dhe zbukurimet e tepërta janë të evitueshme.

KUB House

21. 03. 2023

Ky projekt ideor i një shtëpie është krijuar për të shprehur parimet e thjeshtësisë dhe funksionalitetit, pa pasur ndikim nga kërkesat specifike të klientit. Forma është e drejtpërdrejtë dhe e thjeshtë, dhe çdo detaj është i menduar për të i shërbyer qëllimit, me një lidhje të ngushtë mes formës dhe funksionit që krijon një ambient të ekuilibruar dhe të pastër.

Pjesa nga rruga vepron si një tampon zonë, e cila krijon një distancë të natyrshme nga rruga kryesore dhe siguron një privatësi të plotë për shtëpinë. Në pjesën e pasme, hapësirat e brendshme janë të lidhura organikisht me oborrin, ku krijohet një harmoni e përsosur mes natyrës dhe arkitekturës. duke ofruar një mundësi për të u relaksuar dhe për të shijuar një tërheqje nga jeta e përditshme dhe ku ndjesia e intimitetit është thelbësore.

Siç thotë Mies van der Rohe, **"Përmes thjeshtësisë, arrihet lartësia"** , dhe kjo shtëpi është një shembull i përsosur i konceptit ku estetika lind natyrshëm nga funksioni, dhe çdo element është i krijuar për të përmbushur qëllimin e tij.







“Simplicity is the ultimate sophistication” J.R

pristine contemporary
projekt akademik universitar

21.10.2025

"Takimi i Kohëve" është një koncept arkitektonik që ndërthur kujtesën urbane me shprehjen bashkëkohore, duke ruajtur dhe rinterpretuar gjurmët e historisë si pjesë e një narrative të re hapësinore. Ndërhyrja realizohet në një ndërtesë historike ikonike dhe synon dialogun me të kaluarën në mënyrë poetike e respektuese, pa cenuar identitetin e saj. Një kub bashkëkohor, me karakter të fortë simbolik, integrohet në strukturën ekzistuese si element kulturor dhe ekspozues, duke krijuar hapësira takimi dhe reflektimi. Transparenca në katin përdhes lejon leximin vizual të së vjetrës, ndërsa zhvillimi vertikal i ndërhyrjes kulmon në një restorant panoramik, duke ofruar një përvojë të vazhdueshme ku arkitektura, arti dhe historia bashkohen në një vizion bashkëkohor të balancuar.



Koncepti - Takimi i koheve



Aksonometi - Paraqitja e volumeve në mënyre skematike

Volumi I - Holli Hyrës dhe Hapësira e Gjerë e Muzeut ,Volumi II - Hapësira e Ekspozitave

Volumi III - Qendra Artistike për Fëmijë dhe Kafene ,Volumi IV - Hapësira Administrative

REFIK ANADOL
ECHOES OF THE EARTH: LIVING ARCHIVE
THURSDAY 29 FEB 17:00
SERPENTINE GALLERIES
LONDON, UK

lumenpulse

IALD
UNITED KINGDOM

Me mbi dy vjet eksperiencë profesionale në sektorin e ndërtimit, kontributi im ka qenë i orientuar në përgatitjen e planeve të parafabrikimit, me fokus të veçantë në përdorimin e materialeve ekologjike dhe arkitekturën e qëndrueshme.
Objektivi kryesor ka qenë për të shfrytëzuar maksimalisht përdorimin e materialeve eko dhe për të ofruar një produkt final që është jo vetëm estetikisht i përshtatshëm, por edhe ekologjikisht i përgjegjshëm.
Gjate kesaj periudhe kam arritur te perfundoj me sukses 13 projekte të cilat jane realizuar në disa shtete të ndryshme te Evropës.

Një ndër arritjet më të rëndësishme ka qenë angazhimi im në projektimin dhe rafinimin e linjës luksoze 'Signature Houses', ku kam patur rol kyç në zhvillimin dhe avancimin e konceptit origjinal, një strukturë kubike e ndërtuar nga dy module, e cila është transformuar në një koleksion ekskluziv njësish luksoze, përkatësisht të formave “I, L, T, U”.
Ky proces ka çuar në krijimin e një produkti tërësisht të personalizuar dhe inovativ, të dizajnuar për një klientelë selektive, duke ofruar një kombinim të përkryer të cilësisë dhe efikasitetit maksimal në ndërtim.

Faleminderit !